

## 11.5 RIEMËRIMI I REGJISTRIMIT TË RUAJTUR PËRKOHËSISHT

Regjistrimin, e ruajtur në skedarin e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht, mund ta riemëroni.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**.  
Hapet dritarja **Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**. Në pjesën e sipërme të dritares ndodhet lista e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht (shih fig. 11.3-1).
2. Përzgjidhni regjistrimin nga lista dhe klikoni butonin **Riemëro**.  
Hapet dritarja **Riemërimi**.
3. Te "Emër i ri" shënoni emrin që dëshironi.  
Klikoni butonin **Në rregull**.